



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KOMUNA KLINË
DREJTORIA E ARSIMIT
04 Nr. 111-292/2015
Klinë, më 22.04.2015

Mbështetur në nenin 8, pika 1, të Ligjit të punës nr. 03/L-212 si dhe në nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për arsimin në komnat e Republikës së Kosovës, si dhe në normativin mbi përzgjedhjen e kuadrit mësimor 09/2014, Drejtoria Komunale e Arsimit në Klinë në bashkëpunim me Save the Children publikon:

K O N K U R S

Shkolla fillore “ Motrat Qiriazhi ” Klinë paralelja e ndarë në fshatin Zajm

*-Një edukator për parafillor, për 1(një) vit shkollor, me mundësi vazhdimi .
Do të punojë me orar të plotë me fëmijët e moshës 5-6 vjeç në SHFMU “Motrat Qiriazhi” paralelja e ndarë në fshatin Zajm.*

-Një edukator parashkollor, mbështetës/e (mobilizues/e i/e komunitetit) – për 1(një) vit, me mundësi vazhdimi . Do të punojë me gjysmë-orar (20 orë në javë) me fëmijët e moshës 0-5 dhe familjet e tyre në fshatin Zajm dhe në SHFMU “Motrat Qiriazhi” paralelja e ndarë.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e nevojshme:

- Fakulteti i edukimit – programi parashkollor, shkolla e lartë pedagogjike – drejtimi për edukatorë, fakulteti filozofik – dega e pedagogjisë, fakulteti i shkencave sociale – programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijës.
- Të ketë njohuri për zhvillimin dhe edukimin gjatë fëmijërisë së hershme, të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve.
- Shkathtësi që të punojë në mënyrë të përshtatshme, fleksibile dhe efektive në punë ekipore.
- Shkathtësi të punës me kompjuter.
- Të ketë kreativitet, iniciativë dhe të njoh mirë komunitetin ku vepron dhe nevojat e tyre.
- Trajnimet e vijara për zhvillimin dhe edukimin gjatë fëmijërisë së hershme janë përparësi.

- Raporton në baza të rregullta sipas formatit të caktuar të raportimit për Save the Children, që do të vihet në dispozicion edhe për DKA-n.
- Edukatori/ja parashkollor/e mbështetës/e (mobilizues/e i/e komunitetit) do të punoj nën menaxhimin e Save the Children, në bashkëpunim me menaxherin e linjës sipas përcaktimit nga DKA.

UDHËZIM PËR APLIKIM

1. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në DKA bashkë me fotokopjet e dokumentit të kualifikimit dhe me fotokopjen e certifikatës së lindjes si dhe fotokopje të ndonjë dëshmie shtesë (licenca, trajnime, përvoja e punës në arsim etj.) brenda orarit zyrtar të punës (prej orës 8-16). Dokumentet e pakompletuara nuk do të pranohen si dhe dokumentet e konkurrimit nuk kthehen.

2. Afati i konkurrimit është 7 ditë nga data e publikimit.

3. Në intervistë do të ftohen 3 kandidatë që i plotësojnë kushtet në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.09/2014 si dhe UA nr.17/2009 për procedurat e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë.

4. DKA-ja për orarin e intervistimit, kandidatët e listës së ngushtë do t'i njoftojë me telefon



Drejtori
Hajdin Morina